



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Hyrje në Letërsinë e Krahasuar

Ngarkesa: 4 kredite. 30 orë Leksione + 10 orë seminare

Viti / Semestri: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Gjuhë Angleze, “Studime Britanike dhe Amerikane “

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT –së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJA DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri themelore mbi natyrën ndërdisiplinore të letërsisë së krahasuar. Të nxisë të kuptuarit e lidhjeve estetike, kulturore dhe ideore midis letërsive të kombeve të ndryshme në kohë dhe në hapësirë. Të përgatisë studentët për të analizuar raportet e ndikimeve letrare ndërmjet kulturave dhe traditave të ndryshme letrare botërore.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të njohë studentët me teoritë dhe metodat e letërsisë së krahasuar si fushë studimi.
2. Të aftësojë studentët në identifikimin dhe analizën e lidhjeve ndërmjet autorëve, veprave dhe lëvizjeve letrare nga kultura të ndryshme.
3. Të zhvillojë tek studentët kompetencën për të interpretuar ndikimet dhe dialogët kulturore në letërsi në mënyrë kritike dhe krahasuese.

Rezultatet e pritshme:

Kjo lëndë synon aftësimin e studentëve për ta perceptuar letërsinë si ushqim gjuhësor, mendor dhe shpirtëror që mundëson përparimin e njerëzimit dhe përhapjen e dashurisë midis kombeve anembanë botës, si dhe për të zbuluar se veprat krijuese janë rimarrje të njëra-tjetrës, paçka se ato u përkasin kulturave, kohëve dhe vendeve të ndryshme.